



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar ▾Shërbime ▾Baza ligjore ▾Vendndodhjet e policisë ▾Video ▾
- Programi i transparencës ▾Kontakt ▾Denonco Krimin Kibernetik ▾Drejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- Donacione ▾Rubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja Javore ▾Për sinjalizimin ▾

Breaking News: Shkodër – Finalizohet operacioni policor i koduar “Skuadra” DVP Vlorë/3 shtetas në pranga, për vepra të ndryshme penale.

Sarandë – U kap në flagrancë duke transportuar pajisje elektroshtëpiake të kontrabanduara, të cilat do t’i shiste pa fatura, në Sarandë, procedohet penalisht 34-vjeçari

Shkodër – Tentoi t’i merrte me dhunë, një shumë parash, shitëses së një dyqani, arrestohet autori

Shkodër/Vijon operacioni “Sundimi i ligjit”, kapet një shtetase e shpallur në kërkim



21/12/2023

Rrëshen/Gjatë 12 Orëve Të Fundit, Finalizohen 2 Operacione, Të Koduara “Repsi” Dhe “Fani”

Rrëshen/Gjatë 12 orëve të fundit, finalizohen 2 operacione për parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe goditet një rast i mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, në banesë. Sekuestrohen 4 armë zjarri dhe municion luftarak.

Rrëshen/Në kuadër të operacionit “Repsi”, bazuar në inteligjencën policore, Policia parandalon një ngjarje të mundshme kriminale. Me armë zjarri me vete, kapen në flagrancë në hyrje të Rrugës së Kombit, 2 shtetas (vëllezër). Sekuestrohen 1 kallashnikov me fishekë në fole, gati për qitje, dhe 1 pushkë.

Rrëshen/Në kuadër të operacionit policor të koduar “Fani”, u vu në pranga 1 shtetas që u kap me armë zjarri kallashnikov me fishekë në fole. Sekuestrohen kallashnikovi, 11 krehra dhe municion luftarak.

Kurbin/Sekuestrohet 1 armë zjarri pushkë që u gjet në banesën e një shtetasi, në Fushë Kuqe. Procedohet në gjendje të lirë, për shkak të moshës, pronari i banesës.

Strukturat e DVP Lezhë, në vijim të operacioneve të njëpasnjëshme në fushën e armëmbajtjes pa leje, të zhvilluara në kuadër të megaoperacionit policor mbarëkombëtar të koduar “Sundimi i ligjit”, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga inteligjencia policore, kanë finalizuar 2 operacione për parandalimin e ngjarjeve kriminale dhe kanë goditur një rast të mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, në banesë.

-Në Rrëshen, në kuadër të operacionit “Repsi”, bazuar në informacionet e siguruara se 2 shtetas qarkullonin me armë dhe dyshohet se do të kryenin një ngjarje kriminale kundër personit, shërbimet e Policisë kanë ndërhyrë dhe kanë kapur në flagrancë, në hyrje të Rrugës së Kombit, shtetasit B. Gj. dhe P. Gj. Gjatë kontrollit fizik, këtyre shtetasve iu gjetën 1 armë zjarri kallashnikov me fishekë në fole gati për qitje dhe 1 armë zjarri pushkë.

-Gjithashtu, në Rrëshen, në kuadër të operacionit Fani”, bazuar në informacionet e siguruara se një shtetas që posedonte një armë zjarri kallashnikov, mund të kryente një ngjarje kriminale kundër personit, shërbimet e Policisë kanë ndërhyrë dhe kanë ndaluar shtetasin N. K., si dhe kanë sekuestruar armën e zjarrit kallashnikov që ai posedonte, bashkë me 11 krehra dhe municion luftarak.

-Në Kurbin, bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjencia policore se shtetasi T. Gj. mbante armë zjarri në banesë, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll në banesën e tij, ku kanë gjetur 1 armë zjarri pushkë dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve procedurale për këto raste:

-nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Mirditë u arrestuan në flagrancë shtetasit: B. Gj., 39 vjeç (i dënuar më parë për veprën penale “Dhuna në familje”) dhe P. Gj., 29 vjeç (vëllezër), të dy banues në fshatin Zall Xhuxhë, Mirditë; N. K., 66 vjeç, banues në fshatin Petoq, Mirditë;

-nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Kurbin janë referuar materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin T. Gj.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)